



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite

Ministry of Labour and Social Welfare

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK

2012-2014

Dhjetor 2012



FJALA E MINISTRIT

Politikë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është që të arrihen standardet e Bashkimit Evropian në kohë sa më të shkurtër të mundshme. Ministria pranon që ky proces ndonjëherë do të jetë i vështirë dhe i rëndë për stafin dhe institucionet. Sidoqoftë, ky është një proces i domosdoshëm dhe i vlefshëm. Padyshim që standardet në ministrinë homologe të vendeve të Bashkimit Evropian janë më të larta se tonat dhe ne kemi shumë për të mësuar gjatë këtij procesi.

Në këtë drejtim, ne kemi përfshirë objektivat strategjike, që përcaktojnë një varg të rezultateve që janë dizajnuar për të përmirësuar kompetencën e stafit tonë dhe përmirësimin e efikasitetit operacional të ministrisë. Aktivitetet e planifikuara përfshijnë marrëveshjet për binjakëzime teknike me vendet e BE-së, që janë të njohura për ekselencë në shërbimet e sektorit publik. Ne parashohim se këto marrëveshje do të përfshijnë dërgimin e stafit kyç ministror për të fituar përvojë në vendet anëtare të BE-së dhe për të sjellë ide të reja dhe përparimtare të cilat mund t'i përdorë ministria.

Gjatë vlerësimit tonë të efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve të brendshme të ministrisë, u spikatën deficiencia në shumë fusha të cilave urgjentisht duhet t'u kushtohet vëmendje. Ishte e qartë që procesi i decentralizimit duhej shtyrë përpara dhe që kishte nevojë për rishikim të sistemeve të burimeve njerëzore, veçanërisht përshkrimeve të vendit të punës, specifikimeve për personelin dhe specifikimeve për trajnimet. U identifikua nevoja për një program të zhvillimit dhe të menaxhimit për stafin kyç, që do të prodhojë rezultate, i cili staf do të shërbejë si forcë shtytëse kryesore për përballimin e sfidave të ndryshimeve të tashme dhe të ardhshme në ministri.

Një fushë tjetër problematike ishte nevoja për një sistem informativ efektiv të menaxhimit, që mund të ofrojë të dhëna të azhurnuara dhe të sakta për stafin profesional në ministri, zyra rajonale dhe lokale. Ky do të jetë një proces i shtrenjtë dhe i komplikuar edhe pse i rëndësishëm kritikë. Në të njëjtën kohë, duhet të përmirësohet cilësia e informatave, që u ofrohen stafit tonë profesional. Për këtë qëllim, regjistrimi i popullatës plotëson informatat e pjesshme, që për momentin kemi në dispozicion. Ne jemi të vetëdijshëm që disa nga këto aktivitete do të jenë përtej fushëveprimit të ministrisë, por nuk ka dyshim se një sistem informativ funksional i menaxhimit të tregut të punës është një nga kushtet kryesore për një ministri moderne të punës.

Në fushën e politikave, ekziston një nevojë që të sigurohet reduktimi i varfërisë në tërë vendin dhe orientimi i beneficioneve për të varfrit në varfëri të skajshme. Kjo është një fushë të cilën ministria do ta përmirësojë dhe ne kemi objektiva për natyrën dhe llojet e ndryshimeve që do të përmirësojnë shërbimet tona në këtë fushë. Fushat e pensioneve dhe mirëqenies sociale janë të shtrenjta dhe duhet të financohen. Ekonomia e vendit dhe krijuesit e pasurisë janë çelësi për financimin e këtyre skemave në të ardhmen.

Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

MANDATI I MINISTRISË

Synimi është që të bëhemi një institucion që ofron shërbime në mënyrë efektive, duke zhvilluar një kulturë të përkujdesjes ndaj shfrytëzuesëve të shërbimeve dhe duke ruajtur cilësinë gjatë gjithë kohës. Kjo do të arrihet përmes hulumtimeve, hartimit të ligjeve, politikave, direktivave dhe përcjelljen e implementimit të tyre. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), bazuar në Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- Krijon politikat e punës dhe të mirëqenies sociale si dhe harton dhe zbaton legjislacionin për këto fusha;
- Përkrah dhe zhvillon marrëdhëniet jo diskriminuese të punës dhe punësimit, duke marr parasysh standardet e zbatueshme ndërkombëtare të punës;
- Përcjell ecuritë e punësimit dhe të mirëqenies sociale dhe prezanton masat aktive adekuate të nxitjes së punësimit dhe zvogëlimit të papunësisë si dhe masat pasive adekuate për të përmbushur nevojat në ndihmë sociale për qytetarët nevojtarë;
- Përkrah politikën e veprimit dhe praktikën e punës e të mirëqenies sociale për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve;
- Vendos standarde për siguri dhe mbrojtje në punë të të punësuarve dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- Udhëheq dhe mbikëqyrë institucionet administrative publike të punësimit dhe institucionet e përkujdesjes sociale, të personave në nevojë dhe bashkëpunon me komunat dhe institucionet e përfshira në zbatimin politikave të punësimit dhe mirëqenies sociale;
- Mbikëqyrë kërkesën dhe ofertën për tregun e punës dhe angazhohet për përputhshmërinë e tyre;
- Siguron dhe mbikëqyrë programet e aftësisimit profesional për të papunët dhe punëkërkuarit në drejtim të zhvillimit të burimeve njerëzore, për të përmirësuar mundësitë e tyre të punësimit;
- Nxitë dhe inkurajon dialogun në mes partnerëve socialë (organizatave të punëtorëve, sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe qeverisë);
- Organizon takimet e Këshillit Ekonomiko Social (KES), si organ më i lartë këshillëdhënës i partnerëve socialë për politikën e punësimit, të mirëqenies sociale dhe politikën tjera ekonomike, duke synuar parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve sociale si dhe përfaqëson Qeverinë e Republikës së Kosovës në këtë organ;
- Siguron ndihma financiare nga mjetet e dedikuara për familjet dhe individët nevojtarë;
- Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, që ndërlidhet me punën dhe mirëqenien sociale në përgjegjësinë e kësaj ministrie;
- Administron dhe përkrah sistemin e sigurimit social, duke përfshirë edhe sistemin pensional dhe benefitet e papunësisë;
- Siguron përkrahje financiare dhe sociale, emergjente dhe të përhershme, përmes institucioneve apo shërbimeve të ngritura për këtë qëllim për qytetarët me nevojë;

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE

Gjatë vitit 2008 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si shumica e ministrive tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me mbështetje të projektit FRIDOM ka kryer rishikimin funksional dhe organizativ. Procesi i rishikimit është fokusuar në çështjet e kapacitetit administrativ, objektivat, funksionet, strukturat, procedurat dhe personelin e MPMS-së për sektorin e punës dhe mirëqenies sociale.

Rezultatet e rishikimit funksional për MPMS-në janë paraqitur në një raport analitik, ku janë paraqitur rekomandimet që kanë të bëjnë me organizimin e përgjithshëm, proceset dhe burimet njerëzore të ministrisë. Të gjeturat, që kanë të bëjnë me funksionimin e ministrisë si tërësi, të cilat janë identifikuar nga raporti, janë vlerësuar se qëllimi i tyre është që të përmirësohet performanca e MPMS si një institucion, në masë të madhe nëpërmjet ndryshimeve në organizim, procese dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në aspektin e organizimit të ministrisë raporti ka nxjerr këto përfundime kryesore: është identifikuar një fragmentim në kuadër të MPMS, ku në mes të departamenteve nuk ekziston një koordinim i politikave, por edhe kapacitete të ndara për çdo departament që përfshin funksionet horizontale siç janë ankesat, sistemit të TI dhe arkivit, ekziston numër i njësive të tepërta në të gjitha nivelet dhe përfundimi i tretë ka të bëjë me fragmentimin e brendshëm lidhur me raportimet nga agjencitë ekzekutive dhe departamentet brenda ministrisë. Sa i përket zhvillimit të proceseve, siç janë menaxhimi i performancës, sigurimi i cilësisë, monitorimi, vlerësimi dhe centralizimi i shërbimeve të TI kanë nevojë për përmirësim. Fakti se nuk ekziston njësi në kuadër të ministrisë, që është përgjegjëse për monitorimin e strategjisë dhe planeve tjera, funksioni i monitorimit është i shpërndarë nëpër portfolio të ndryshme brenda ministrisë, është e nevojshme që për këto funksione të jetë përgjegjës një departament përkatës brenda MPMS. .

Raporti ka nxjerrë tri lloje të rekomandimeve: rekomandimet dhe gjetjet e para adresojnë çështjet e organizimit, proceseve dhe burimeve njerëzore, ndërsa dy llojet tjera të rekomandimeve kanë të bëjnë me fushat specifike: portfolio e puna/punësimi dhe portfolio sociale/familjare.

MPMS në vitin 2010 ka aprovuar Strategjinë Sektoriale 2009-2013, në kuadër të të cilit dokument është vendosur një objektivë strategjike për të adresuar çështjet e organizimit, funksionimit, ngritjes së kapaciteteve administrative të ministrisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2010, me mbështetje të projektit "Mbështetje MPMS-së nga BE-ja", financuar nga KE, është hartuar Plani i Veprimit 2011-2013 për implementimin e strategjisë sektoriale, i cili plan është aprovuar në mars 2011. Një pjesë e rekomandimeve të dala nga raporti i projektit FRIDOM janë shndërruar në objektiva operationale në kuadër të Plani të Veprimit 2011-2013, të cilat janë pasuar me aktivitete përcjellëse për zbatim.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE SEKTORIALE

Misioni i ministrisë është *fuqizim dhe krijim i hapësirës për mirëqenie sociale, duke krijuar infrastrukturë për punësim dhe aftësim profesional, që do të ngritë cilësinë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale*. Sikur është theksuar në Strategjinë Sektoriale 2009-2013, politika e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është për të arritur standardet e Bashkimit Evropian në një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Ministria pranon se procesi mund të jetë nganjëherë i vështirë si për stafin ashtu edhe institucionin. Në analizën e bërë, Strategjia Sektoriale ka vënë në pah disa mungesa në efikasitet dhe efektivitet të proceseve të brendshme të ministrisë, të cilat kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme. Për të adresuar sfidat ekzistuese në fushën e punësimit dhe sistemin e mirëqenies sociale si dhe për të realizuar misionin e saj, ministria ka vendosur këto objektiva strategjike sektoriale:

Objektiva Strategjike 1. Ngritja e shkallës së punësimit dhe ngritja e aftësive profesionale, varësisht nga kërkesat e tregut të punës.

MPMS-ja, si përgjegjëse në formulimin, realizimin e politikave dhe masave të punësimit, përmes kësaj objekteve, vëmendje të veçantë i ka kushtuar hartimit dhe zbatimit të politikave të punësimit dhe aftësimeve profesionale. Përgjegjësitë e MPMS-së përfshijnë formulimin dhe implementimin e politikave aktive dhe atyre pasive të tregut të punës siç janë ndërmjetësimi për punë, punët publike, aftësimi profesional, ri-trajnimi dhe iniciativat e zhvillimit të bizneseve të vogla/vetë-punësimi, subvencionimi i pagave etj. Politikat e tregut të punës mund ta përmirësojnë mundësinë për punësim, ta lehtësojnë tranzicionin në tregun e punës, të kontribuojnë që më mirë të përshtatet kërkesa me ofertën dhe të ndihmojnë ri-integrimin e grupeve të cenueshme.

Në shërbimet publike të punësimit (SHPP) ka një rrjet të institucioneve të punësimit dhe trajnimit, që kryejnë disa funksione, duke përfshirë edhe regjistrimin e punëkërkuesve, dhënie informatave për tregun e punës, kryerjen e hulumtimeve të tregut të punës, ofrimin e programeve të këshillimit për karrierë dhe të trajnimit. Shërbimet e tilla përkrahen nga mbi 200 punëtorë të punësimit që punojnë në shtatë qendra regjionale të punësimit, 23 zyra komunale të punësimit dhe 8 qendra të aftësimin profesional. Nevojitet edhe më shumë punë për të reformuar strukturën dhe organizimin e SHPP-ve që të bëhet agjenci moderne e shërbimit publik, për t'i mundësuar që të ofrojë shërbime efektive. SHPP nuk ka një sistem të besueshëm kombëtar të informatave të tregut të punës, që shpesh e bën ofrimin e këshillave, udhëzimeve profesionale dhe informatave për karrierë joefektive apo jorelevante. Departamenti i Punësimit dhe Inspektorati i Punës, aktualisht mbulojnë fushën e punës dhe punësimit brenda MPMS-së. Duke pasur parasysh këtë fakt është e nevojshme që të bëhet riorganizimi dhe fuqizimi i këtyre strukturave institucionale, të cilat do të mundësojnë që të adresojnë sfidat dhe problemet në fushën e punësimit dhe aftësimeve profesionale. Për nevojat e riorganizimit të strukturave ekzistuese, zhvillimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore dhe fuqizimin e proceseve të komunikimit, janë caktuar masat dhe veprimet të cilat do të jenë pjesë e këtij plani zhvillimor.

Objektiva Strategjike 2. Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes për familjen në komunitet dhe puna në drejtim të zvogëlimit të varfërisë në Kosovë.

Më qëllim të forcimit të sistemit të mirëqenies sociale në favor të mbështetjes së familjeve të varfra dhe të cenuara nëpërmjet transfereve të llojeve të ndryshme të të ardhurave publike, objektivi orientohet në përcaktimin e të ardhurave minimale dhe luftimi i varfërisë, zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve kualitative sociale në komunitet, bashkëpunimin dhe fuqizimin e partneritetit në të gjitha nivelet e shoqërisë civile dhe institucionet përgjegjëse për krijimin e rrjetit të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave e informatave .

Sistemi i tanishëm i mirëqenies sociale në Kosovë përbëhet nga përfitimet e asistencës sociale për të varfrit me një rrjet të 35 qendrave të punës sociale të shtrirë nëpër komuna të Kosovës, që përveç kësaj ofrojnë shërbime këshillimi dhe udhëzimi për individët dhe familjet që janë në rrezik (kundërvajtësit e rinj, jetimët, viktimat e dhunës familjare, etj). Gjithashtu ekzistojnë një numër i institucioneve (10 shtëpi të komunitetit) me shtrirje në disa regjione për kujdesin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuar.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është institucioni në nivelin qendror të qeverisjes, që trajton të gjitha çështjet lidhur me mirëqenien sociale. Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS) është trupi kyç përbrenda MPMS-ë i cili ka përgjegjësinë për çështjet e mirëqenies sociale. Departamenti ka një funksion mbikëqyrës, por jo funksion menaxherial kundrejt qendrave për punë sociale, të cilat janë decentralizuar në menaxhim të komunave në fillim të vitit 2009. Ligji i Shërbimeve Sociale dhe Familjare ka përcaktuar saktë rolin dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve sociale, monitoruesve dhe politikbërësve, siç janë komunat, qendrat për punë sociale, OJQ-të, departamentet brenda MPMS-së si dhe ministrive tjera nga niveli qendror (MAPL dhe MF).

Ekziston nevoja e qartë për rregullimin administratës complete të shërbimeve sociale dhe familjare në të gjitha nivelet e qeverisjes, prezantimi i standardeve të kualitetit të shërbimeve sociale, regjistrimi i organizatave, i iniciativave të bazuara në komunitet si dhe i profesionistëve aktivë në fushën e shërbimeve sociale. Megjithatë ekzistojnë nevojat për riorganizimin e strukturave ekzistuese në nivel të MPMS-së, zhvillimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore dhe fuqizimin e proceseve të komunikimit në fushën e mirëqenies sociale. Për të gjitha këto janë paraqitur masat dhe veprimet që do të zbatohen e që janë pjesë e këtij plani.

Objektiva Strategjike 3. Niveli i shërbimeve të ofruara nga MPMS-ja në harmoni të plotë me legjislacionin, sistemet dhe standardet e BE-së.

Objektivë e çdo institucioni, po ashtu edhe MPMS-së, është që të ngritë nivelin e ofrimit të shërbimeve konform legjislacionit dhe standardeve të cilat aplikojnë vendet e BE-së. Një gjë e tillë kërkon që të ekzistojnë resurset e nevojshme financiare, mekanizma funksional dhe kapacitete njerëzore të specializuara për fusha specifike.

Sa i përket fushës së mirëqenies sociale dhe familjes ka kapacitet që në aspektin kuantitativ është e krahasueshme me vendet e vogla të BE-së, por në fushën e punësimit ka mungesë të kapaciteteve për t'u marrë me ligjin, shëndetin, sigurinë në punë dhe dialogun social krahasuar me vendet e BE-

së. Megjithatë ekzistojnë nevojat që resurset aktuale të ngritin performancën e tyre për të zhvilluar dhe ofruar shërbimet me të avancuara dhe konform standardeve ndërkombëtare. Proceset e brendshme të komunikimit, raportimit dhe administrimit të disa funksioneve të shërbimeve administrative dhe financiare kanë nevojë për një ristrukturim. Po ashtu ekziston një numër i njësisive në secilin departament që merret me çështjen e ankesave, teknologjisë informative, arkivimit dhe pagesave. Kjo është vlerësuar se krijon një joefikasitet dhe pamundësi të menaxhimit më të mirë të shërbimeve administrative dhe financiare. Për adresimin e nevojave të ristrukturimit, ngritjen e performancës së stafit, reduktimin e disa njësisive të tepërta janë caktuar masat dhe veprimet të cilat do të jenë pjesë e këtij plani.

Objektiva Strategjike 4. Zhvillimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit (anëtare të BE-së dhe atyre jashtë BE) për rritjen e mundësive për punësim të fuqisë punëtore nga Kosova.

Zhvillimi i bashkëpunimit në nivel të rajonit dhe me vendet të BE-së është një domosdoshmëri në proceset e integrimi evropiane. Kjo kërkon që edhe në kuadër të MPMS-së, procesi i integrimi evropiane të ketë një vëmendje të veçantë sa i përket hartimit të legjislacionit të fushës së mbrojtjes sociale dhe të punësimit, më qëllim të arritjes së marrëveshjeve bilaterale për punësim dhe sigurimeve sociale me vendet e rajonit dhe të BE-së. Marrë parasysh koordinimin jo të mirë të politikave në nivel të ministrisë dhe mungesën e një koordinimi të fushës së sigurimeve sociale, ka nevojë për të krijuar mekanizma të cilët do të mundësojnë që të lehtësojnë arritjen e marrëveshjeve bilaterale në fushën e punësimit dhe të sigurimeve sociale me vendet e ndryshme. Gjithashtu është e nevojshme të ndërtohet mbështetja e specializuar për marrëdhëniet me BE-në dhe kapacitete të mjaftueshme të stafit vendor, që do të adresojnë kërkesat për integrimi dhe tërheqjen e donatorëve për këtë sektorë. Për të adresuar nevojat e riorganizimit të strukturave ekzistuese, zhvillimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore dhe fuqizimin e proceseve të koordinimit të politikave si dhe fushës së koordinimit të sigurimeve sociale, janë caktuar masat dhe veprimet të cilat do të jenë pjesë e këtij plani zhvillimor.

Objektiva Strategjike 5. Sistem pensional tre shtyllash, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale për të gjitha kategoritë e pensioneve.

Institucionet kryesore që merren me krijimin e kornizën ligjore dhe menaxhimin e pensioneve në Kosovë vazhdojnë të janë të segmentuar dhe nuk ekziston një koordinim i mirëfilltë në mes të institucioneve të cilat janë përgjegjëse për ta zhvilluar këtë fushë. Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovë pranë MPMS-së është institucioni përgjegjës që merret me kornizën dhe menaxhimin e skemave pensionale, të cilat financohen nga buxheti i Kosovës, ndërsa mekanizmi tjetër që merren më çështje pensionale është edhe Trusi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) si organ i pavarur i krijuar për administrim të kursimeve të programit pensional në interesin më të mirë të kontribuuesve. TKPK menaxhohet nga një bord shtatë anëtarësh, të cilët zgjidhen dhe aprovohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga Banka Qendrore e Kosovës, si institucion përgjegjës për monitorimin e fondeve të ndryshme pensionale, është rregulluar korniza ligjore për TKPK-në. Po ashtu

Banka Qendrore e Kosovë rregullon dhe monitoron punën e ofruesit vendor, por mund të lejojë edhe ofrues të jashtëm të veprojnë në këtë fushë.

Në mungesë të të dhënave nga regjistrimi i popullsisë është vështirë të identifikohet numri i saktë i shkallës së mbulueshmërisë së pensionit bazë. Mirëpo shifrat e tanishme tregojnë se skema është universale ku numri i përfituesve është pothuajse e njëjtë me vlerësimet për numrin e popullsisë mbi 65 vjeç në Kosovë. Përveç kësaj skeme ekzistojnë edhe disa skema tjera nën administrim të MPMS-së që financohen nga buxheti i Kosovës, por të cilat menaxhohen nga departamentet, zyrat regjionale dhe zyrat lokale nëpër komuna. Kjo ka bërë që i gjithë angazhimi i menaxhmentit të këtyre institucioneve të përqendrohet në zbatimin e këtyre skemave, ndërsa funksioni i zhvillimit dhe koordinimit të politikave pensionale të mbetet i neglizhuar. Sa i përket kornizës ligjore të fushës së pensioneve, gjatë vitit 2011 janë marrë veprimet e nevojshme që kjo kornizë të krijoj mundësi të avancimit dhe zhvillimit të sistemit të pensioneve. Megjithatë ekzistojnë nevojat për riorganizimin e funksioneve të segmentuara, të cilat merren me krijimin e kornizës ligjore, zhvillimin e politikave pensionale dhe koordinimin e fushës së sigurimeve sociale. Për të gjitha këto, në kuadër të këtij plani, janë paraqitur masat dhe veprimet që do të adresojnë disa nga rekomandimet e procesit të rishikimit funksional të fushës së pensioneve.

MASAT E ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL

Për implementimin e rekomandimeve të dala nga raporti i FRIDOM-it , siç është potencuar edhe me lartë, MPMS ka vendosur objektiva operacionale dhe ka identifikuar aktivitetet në kuadër të Planit të Veprimit 2011-2013. Raporti i rishikimit funksional ka identifikuar një numër masash të cilat duhet të ndërmerren menaxhmenti i ministrisë për të krijuar një strukturë me përgjegjësi e kompetencë të qartë në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale. Duke pasur parasysh detyrat dhe përgjegjësitë të disa njësive organizative, ndërlihdhen në mes të fushëveprimit të tyre si dhe mangësitë në punën e deritanishme të këtyre njësive organizative, disa nga rekomandimet janë të pranueshme dhe mund të zbatohen me lehtë.

Masat dhe veprimet e deritanishme që ka ndërmarrë menaxhmenti i MPMS-së për zbatimin e rekomandimeve nga raportit analitik janë: shuarja e të gjithë sektorëve në kuadër të departamenteve të MPMS-së, koordinimi i aktiviteteve të fushës së TI dhe krijimi i disa mekanizmave të koordinimit. Masat tjera do të prezantohen në vijim në kuadër të objektivave sektoriale ,të cilat do të jenë pjesë e proceseve të zbatimit, përmes vendimeve që do të ndërmerren në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme.

Objektiva Strategjike 1. Ngritja e shkallës së punësimit dhe ngritja e aftësive profesionale, varësisht nga kërkesat e tregut të punës.

- ❖ **Masa 1.1:** Krijimi i kapaciteteve për dizajnim të politikave në nivel të ministrisë për marrëdhënien e punës dhe punësimit. Riorganizimi i Departamentit të Punësimit, duke ndarë përgjegjësitë e hartimit të politikave në një divizion të veçantë me ato të koordinimit të zyrave regjionale dhe komunale të punësimit, që aktualisht kryhen nga i njëjti divizion (Divizioni i Punësimit).
- ❖ **Masa 1.2:** Riorganizimi i trajnimeve profesionale përmes krijimit të kapaciteteve të nevojshme në ofrimin e shërbimeve të trajnimeve sipas kërkesave të tregut të punës. Në një periudhë afatmesme shndërrimi Divizionit të Aftësimeve Profesionale në agjenci, që do të menaxhoj me fondin e trajnimeve profesionale dhe kontraktot ofruesit privat të shërbimeve të trajnimit.
- ❖ **Masa 1.3:** Organizimi i shërbimeve të punësimit përmes ndarjes së përgjegjësisë të zhvillimit, hartimit të legjislacionit dhe monitorimit të fushës së punësimit e kohezionit social të implementuar nga Departamenti i Punësimit me përgjegjësitë për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit të cilat do të implementohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Objektiva Strategjike 2. Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes për familjen në komunitet dhe puna në drejtim të zvogëlimit të varfërisë në Kosovë.

- ❖ **Masa 2.1** Fuqizimi dhe krijimi i mekanizmave me përgjegjësi të definuar qartë për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Departamenti i Mirëqenies Sociale të shndërrohet në Departament për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), ndërsa Departamenti i Institutit të Politikave Sociale të shuhet dhe të jetë pjesë e departamentit të rikrijuar (DPSF) i barabartë me divizionet tjera.
- ❖ **Masa 2.2:** Krijimi i mekanizmit për inspektimin e shërbimeve sociale dhe familjare, fillimisht përmes krijimit të një njësie të inspektimit brenda DPSF, kurse në periudhë afatmesme të themelohet agjenci për inspektimin e shërbimeve sociale.

Objektiva Strategjike 3. Niveli i shërbimeve të ofruara nga MPMS-ja në harmoni të plotë me legjislacionin, sistemet dhe standardet e BE-së.

- ❖ **Masa 3.1:** Fillimi i aplikimit të një sistemi eksplicit të menaxhimit të performancës dhe përforcimit të kapaciteteve për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- ❖ **Masa 3.2:** Riorganizimi i funksioneve të shqyrtimit të ankesave dhe komisioneve në shkallën e II-të në kuadër të Departamentit Ligjor. Themelimi i një divizioni, i cili do të adresonte të gjitha çështjet e ankesave, kontesteve dhe do të organizohej puna e komisioneve të ndryshme.

- ❖ **Masa 3.3:** Shndërrimi i Departamentit të Shërbimit Qendror Administrativ në Departamentin për Administratë Qendrore (DAQ), ndërsa në kuadër të tij bëhet edhe riorganizimi i shërbimeve të arkivit, përkthimeve dhe fushës së teknologjisë informative.
- ❖ **Masa 3.4:** Organizimi i funksioneve të ekzekutimit për prokurim dhe financa në një periudhë afatmesme do të organizohen në një departament të përbashkët, ndërsa funksioni i planifikimeve dhe i përgatitjes së projekteve do të kalojë nën përgjegjësinë e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Objektiva Strategjike 4. Zhvillimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit (anëtare të BE-së dhe atyre jashtë BE) për rritjen e mundësive për punësim të fuqisë punëtore nga Kosova.


- ❖ **Masa 4.1:** Funksionalizimi i mekanizmit për koordinim dhe monitorim të politikave, strategjive dhe planeve në nivel të ministrisë. Kjo do të bëhet përmes fuqizimit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në kuadër të të cilit do të adresohen edhe përgjegjësitë për koordinimin e fushës së sigurimeve sociale.

Objektiva Strategjike 5 ; Sistem pensional tre shtyllash, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale, për të gjitha kategoritë e pensioneve.

- ❖ **Masa 5.1:** Riorganizimi i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës fillimisht duke emërtuar Departamenti i Pensioneve, ndërsa në kuadër të këtij departamenti do të krijohen mekanizmat për zhvillimin dhe monitorimin e politikave pensionale.
- ❖ **Masa 5.2:** Në periudhë afatmesme, për administrimin e të gjitha skemave të financuara nga buxheti i shtetit, themelohet Agjencia e Administratës Pensionale, ndërsa funksionet e zhvillimit dhe monitorimit të politikave për të gjitha llojet e pensioneve dhe beneficioneve do të organizohen në kuadër të Departamentit të Pensioneve.
- ❖ **Masa 5.3:** Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave koordinues për shkëmbimin e të dhënave në mes Departamentit të Pensioneve, si përgjegjës për administrim të skemave pensionale të shtyllës së I-rë të pensioneve dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës që administrojnë kontributet pensionale të shtyllës së II-të të pensioneve.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I MINISTRISË


Organogrami nr.1 – Struktura organizative para se të fillohet me zbatimin e disa nga rekomandimet e procesit të rishikimit funksional për MPMS-në



VERSIONI I-rë

Masat dhe veprimet e planifikuara nga menaxhmenti i MPMS-së për zbatim krijojnë mundësinë që në një afat të shkurtër ministria të ka këtë strukturë të re organizative.

Organogrami nr.2 –Faza e parë e zbatimit të masave dhe veprimeve afatshkurtëra do të rezultojë me këtë strukturës organizative të MPMS-së;



Ngjyra ari; nënkupton shëndrrimin e disa njësive ekzistuese me emërtim të ri dhe përgjegjësi të reja
Ngjyra gjelbërt; nënkupton njësitë e reja të krijuara dhe të transferuara nga zyrat apo njësit tjera.
Ngjyra kaltërt; nënkupton njësitë dhe strukturat ekzistuese të cilat nuk do të ndryshojnë

PLANI I VEPRIMIT

Objektiva Strategjike 1. Ngritja e shkallës së punësimit dhe ngritja e aftësive profesionale, varësisht nga kërkesat e tregut të punës.

Masa 1.1	Krijimi i kapaciteteve për dizajnim të politikave në nivel të ministrisë për marrëdhënien e punës dhe punësimit. Riorganizimi i Departamentit të Punësimit, duke ndarë përgjegjësitë e hartimit të politikave në një divizion të veçantë me ato të koordinimit të zyrave regjionale dhe komunale të punësimit, që aktualisht kryhen nga i njëjti divizion (Divizioni i Punësimit).	MPMS, Departamenti i Punësimit			Mars 2012	
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
1.1.1	Shndërrimi i Divizionit të Punësimit në Divizionin e Politikave të Punësimit dhe krijimi i Divizionit të Koordinimit dhe Monitorimit të zyrave regjionale të punësimit (ZRP) dhe zyrave komunale të punësimit (ZKP).	Janar 2012	MPMS/DPP	MAP		
1.1.2	Përgatitja e përshkrimit të mandatit dhe përgjegjësi të Divizionit të Politikave të Punësimit dhe Divizionit të Koordinimit dhe Monitorimit të ZRP/ZKP	Shkurt 2012	DPP	MAP		
1.1.3	Plotësimi dhe kompletimi me staf të nevojshëm nga burimet e brendshme për të dy divizionet të krijuara dhe përshkrimi i vendeve të punës për secilin zyrtar që do të jetë i punësuar në kuadër të këtyre divizioneve.	Mars 2012	DPP, Divizioni Personeli	MAP		
Masa 1.2	Riorganizimi i trajnimeve profesionale përmes krijimit të kapaciteteve të nevojshme në ofrimin e shërbimeve të trajnimeve sipas kërkesave të tregut të punës. Në një periudhë afatmesme shndërrimi Divizionit të Aftësimeve Profesionale në një agjenci që do të menaxhoj me fondin e trajnimeve profesionale dhe kontraktot ofruesit privat të shërbimeve të trajnimit.	MPMS, Departamenti i Punësimit			Mars 2013	

Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
1.2.1 Hartimi dhe aprovimi i legjislacionit të nevojshëm për krijimin e mundësive për ofrimin e trajnimeve profesionale nga sektori privat përmes kontraktimit dhe blerjes së shërbimeve për kategoritë e trajnimeve që nuk ofrohen nga QAP.	Qershor 2012	DPP, Divizioni Aftësimeve Profesionale	MASHT, MTI		
1.2.2 Funkcionalizimi i Fondit të Trajnimeve Profesionale për zhvillimin dhe financimin e programeve të reja të trajnimeve në bazë të kërkesave të tregut të punës.	Mars 2012	DPP, Divizioni Aftësimeve Profesionale	MF		
1.2.3 Me rastin e kompletimit të kornizës ligjore Divizioni i Aftësimeve Profesionale, përfshirë QAP do të shndërrohet në Agjenci për Trajnime Profesionale.	Qershor 2013	MPMS, DPP	MAP, MASHT, MTI, MF		
Masa 1.3	Organizimi i shërbimeve të punësimit përmes ndarjes së përgjegjësive të zhvillimit, hartimit të legjislacionit dhe monitorimit të fushës së punësimit e kohezionit social të implementuar nga Departamenti i Punësimit me përgjegjësitë për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit të cilat do të implementohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.		MPMS, Departamenti i Punësimit	Shtator 2012	
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
1.3.1 Hartimi dhe aprovimi i legjislacionit për organizimin e shërbimeve të punësimit dhe krijimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit	Qershor 2012	MPMS, DPP	ZKM, Kuvendi i Kosovës		
1.3.2 Themelimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimit si institucion i cili do të menaxhoj dhe implementoj politikat e punësimit.	Shkurt 2013	MPMS, DPP	ZKM, Kuvendi i Kosovës		

Objektiva Strategjike 2. Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes për familjen në komunitet dhe puna në drejtim të zvogëlimit të varfërisë në Kosovë.

Masa 2.1	Fuqizimi dhe krijimi i mekanizmave me përgjegjësi të definuar qartë për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Departamenti i Mirëqenies Sociale të shndërrohet në Departament për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), ndërsa Departamenti i Institutit të Politikave Sociale të shuhet dhe të jetë pjesë e departamentit të rikrijuar (DPSF) i barabartë me divizionet tjera.	MPMS, Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Mirëqenies Sociale	Mars 2012		
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
2.1.1 Shndërrimi i Departamentit të Mirëqenies Sociale në Departamentin e Politikave Sociale dhe të Familjes.	Janar 2012	MPMS, Zyra e Sekretarit	ZKM, MAP		
2.1.2 Departamenti i Institutit të Politikave Sociale të shuhet dhe të jetë pjesë e Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes, i barabartë me divizionet tjera.	Janar 2012	MPMS, DPSF , Zyra e Sekretarit	ZKM,MAP		
2.1.3 Shndërrimi i Divizionit të Analizave Buxhetore dhe Vlerësimit të Varfërisë në Divizion për Planifikim dhe Përfshirje Sociale	Janar 2012	MPMS, DPSF	MAP		
2.1.4 Divizioni i Përkujdesjes Institucionale të emërtohet Divizioni i Aftësisë së Kufizuar dhe Personave të Moshuar.	Janar 2012	MPMS,DPSF	MAP		
2.1.5 Fuqizimi i Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale e Familjare dhe i mekanizmave për licencimin e punëtorëve socialë dhe ofruesve të shërbimeve sociale e familjare.	Janar 2012	MPMS, DPSF	MF		

Masa 2.2	Krijimi i mekanizmit për inspektimin e shërbimeve sociale dhe familjare ,fillimisht përmes krijimit të një njësie të inspektimit brenda DPSF, ndërsa në periudhë afatmesme të themelohet agjenci për inspektimin e shërbimeve sociale.			MPMS, Departamenti i Mirëqenies Sociale	Shtator 2013
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
2.2.1 Krijimi i një njësie të inspektimit brenda DPSF në përbërje prej 2-3 inspektorëve, për inspektimin e shërbimeve sociale dhe familjare.	Qershor 2012	MPMS,DPSF	MF		
2.2.2 Themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë për Inspektimin e Shërbimeve Sociale.	Shtator 2013	MPMS,DPSF	MAP		

Objektiva Strategjike 3. Niveli i shërbimeve të ofruara nga MPMS-ja në harmoni të plotë me legjislacionin, sistemet dhe standardet e BE-së.

Masa 3.1	Fillimi i aplikimit të një sistemi eksplicit të menaxhimit të performancës dhe përforcimit të kapaciteteve për menaxhimin e burimeve njerëzore.			MPMS, DPSHA		Qershor 2012
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit	
3.1.1 Instalimi i sistemit të menaxhimit të performancës për punën e njërive dhe stafit punonjës të ministrisë.	Mars 2012	DSHPA Divizioni i Personelit	MAP			
3.1.2 Përgatitja e një vlerësimi të nevojave të trajnimit për stafin punonjës dhe shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në njësitë e krijuara.	Mars 2012	Departamentet , Divizioni i Personelit	MAP, IKAP			
3.1.3 Rishikimi dhe përgatitja e përshkrimit të punës rreth përgjegjësive dhe obligimeve të secilit departament dhe divizion.	Shkurt 2012	DPSHA, Divizioni i Personelit	MAP			
3.1.4 Përgatitja e përshkrimeve të punës për secilën pozitë të plotësuar me zyrtarë dhe për vendet e planifikuara për t'u plotësuar.	Janar 2012	DPSHA , Divizioni i Personelit	MAP			
3.1.5 Kompletimi i divizioneve të krijuara me staf profesional dhe plotësimi i vendeve të zbrazëta.	Qershor 2012	Zyra e Sekretarit departamentet e ministrisë	MAP, MF			
3.1.6 Hartimi i një plani të trajnimit bazuar në identifikimin e nevojave të trajnimit gjatë procesit të vlerësimit.	Qershor 2012	Departamentet dhe Divizioni i Personelit	MAP, MIE			

Masa 3.2	Riorganizimi i funksioneve të shqyrtimit të ankesave dhe komisioneve në shkallën e II-të në kuadër të Departamentit Ligjor. Themelimi i një divizioni, i cilit do të adresonte të gjitha çështjet e ankesave, kontesteve dhe do të organizohej puna e komisioneve të ndryshme.	MPMS, Departamenti Ligjor			Qershor 2012
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
3.2.1 Themelimi i Divizionit të Komisioneve dhe Ankesave në kuadër të Departamentit Ligjor.	Janar 2012	Zyra e Sekretarit	MAP		
3.2.2 Transferi i Zyrës së Komisionit Mjekësor dhe Zyrës për Parashtresa dhe Ankesa nga përgjegjësia e Sekretarit të Përgjithshëm në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të Departamenti Ligjor.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit	MAP		
3.2.3 Ngritja e kapaciteteve të nevojshme për hartimin dhe harmonizimin e ligjeve në Departamentin Ligjor	Qershor 2012	Zyra e Sekretarit	MAP, MF		
Masa 3.3	Shndërrimi i Departamentit të Shërbimit Qendror Administrativ në Departamentin për Administratë Qendrore (DAQ), ndërsa në kuadër të tij bëhet edhe riorganizimi i shërbimeve të arkivit, përkthimeve dhe fushës së teknologjisë informative.	MPMS, MAP, Zyra e Teknologjisë Informative			Qershor 2012
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
3.3.1 Departamenti i Shërbimit Qendror Administrativ emërtohet Departamenti për Administratë Qendrore (DAQ).	Janar 2012	Zyra e Sekretarit	MAP		
3.3.2 Themelimi i Divizionit të Mbështetjes Administrative në DAQ në kuadër të të cilit divizion do të organizohen shërbimet e lektorimit, përkthimit etj.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit DSHPA	MAP		
3.3.3 Hartimi i rregullores së brendshme që përcakton procedurat e regjistrimit dhe arkivimit për dokumentacionin dhe shkresat që qarkullojnë në mes të departamenteve brenda ministrisë dhe shkresave që hyjnë dhe dalin nga ministria.	Mars 2012	DSHPA, DL	ZKM		
3.3.4 Themelimi i Divizionit të TI në kuadër të Departamentit të Administratës Qendrore	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit DSHPA	MAP		

3.3.5 Hartimi i përshkrimit të punës dhe kompletimi me staf nga burimet e brendshme i Divizionit të TI	Shkurt 2012	Divizioni i Personelit	MAP		
3.3.6 Akomodimi i stafit të divizionit në objektin e njëjtë ku ekzistojnë edhe pajisjet e TI të sistemeve aktuale të menaxhimit të të dhënave të pagesave sociale dhe të punësimit	Qershor 2012	DSHPA	MAP		
3.3.7 Funkcionalizimi i plotë i sistemit të integruar informativ për bazat e të dhënave të skemave të mirëqenies sociale	Shtator 2012	Departamentet dhe Zyra e TI	MAP		
3.3.8 Trajnimi i stafit të nivelit qendror dhe lokal të përdoruesve të sistemit të integruar informativ	Dhjetor 2012	Zyra e TI , Departamentet	MAP,IKAP		
3.3.9 Digjitalizimi i dokumentacionit dhe krijimi i arkivit elektronik për secilën njësi brenda ministrisë	Dhjetor 2012	Zyra e TI ,	MAP		
Masa 3.4	Organizimi i funksioneve të ekzekutimit të financave dhe prokurimit në një periudhë afatmesme do të organizohen në një departament të përbashkët, ndërsa funksioni i planifikimeve dhe i përgatitjes së projekteve do të kalojë nën përgjegjësinë e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave.		MPMS,MF, Drejtoria e Financave		Janar 2013
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
3.4.1 Në kuadër të Departamentit të Financave themelohen dy divizione Divizioni i Pagesave dhe Divizioni i Raportimit.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit D.Financave	MF		
3.4.2 Departamenti i Prokurimit do të jetë i organizuar vetëm në nivel të zyrarëve	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit	MAP		
3.4.3 Departamenti i Financave dhe Departamenti i Prokurimit në periudhën afatmesme do të organizohen në një departament të përbashkët.	Janar 2013	Zyra e Sekretarit	MAP ,MF etj.		
3.5.4 Funksionet e planifikimit dhe përgatitjes së projekteve do të kalojnë nën përgjegjësinë e DIEKP.	Mars 2012	Zyra Sekretarit	MF		

Objektiva Strategjike 4. Zhvillimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit (anëtare të BE-së dhe atyre jashtë BE) për rritjen e mundësive për punësim të fuqisë punëtore nga Kosova.

Masa 4.1	Funksionalizimi i mekanizmit për koordinim dhe monitorim të politikave, strategjive dhe planeve në nivel të ministrisë. Kjo do të bëhet përmes fuqizimit të Departamentit për Integrimë Evropiane dhe Koordinim të Politikave në kuadër të të cilit do të adresohen edhe përgjegjësitë për koordinimin e fushës së sigurimeve sociale.	MPMS, Sekretari i Përgjithshëm			Tetor 2012	
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
4.1.1	Rekrutimi i drejtorit të Departamentit për Integrimë Evropiane dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)	Janar 2012	Zyra e Sekretarit,	MAP, MIE		
4.1.2	Përgatitja e përshkrimit dhe specifikimit të punës dhe strukturës së DIEKP, për përgjegjësitë e secilit divizion dhe krijimi i përshkrimeve të punës për pozitat e punës në kuadër të këtyre divizioneve	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit, DP	MAP, MIE		
4.1.3	Themelimi i Divizionit të Integrimëve Evropiane, Divizionit i Planifikimit e Koordinimit të Politikave dhe Divizionit të Marrëveshjeve Bilaterale për Sigurime Sociale dhe Punësim	Janar 2012	Zyra e Sekretarit DIEKP	MAP, MIE		
4.1.4	Kompletimi me staf i të gjitha divizioneve me mundësi të shfrytëzimit të burimeve të brendshme, por në mungesë të potencialeve të brendshme do të bëhet rekrutimi përmes konkursit.	Qershor 2012	DIEKP, Divizioni i Personelit	MAP		
4.1.5	Ngritja e kapaciteteve të stafit të të gjitha departamenteve për dizajnim dhe monitorim të politikave si dhe përgatitjen e projekt propozimeve.	Tetor 2012	DIEKP, Divizioni i Personelit	MAP, MIE		

Objektiva Strategjike 5. Sistem pensional tre shtyllash, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale nga të gjitha kategoritë e pensioneve.

Masa 5.1	Riorganizimi i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, fillimisht duke emërtuar Departamenti i Pensioneve, ndërsa në kuadër të këtij departamenti do të krijohen mekanizmat për zhvillimin dhe monitorimin e politikave pensionale.	MPMS, MAP, BQK , Departamenti i Pensioneve			Dhjetor 2013	
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
5.1.1	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës emërtohet Departament i Pensioneve.	Janar 2012	Zyra e Sekretarit	MAP		
5.1.2	Shndërrimi i Divizionit të Pagesave të Skemave Pensionale në Divizion të Politikave Pensionale, që do të merret me planifikimin dhe dizajnimin e politikave pensionale afatmesme dhe afatgjata.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit Departamenti i Pensioneve	MAP		
5.1.3	Themelimi i Divizionit për Monitorim dhe Kontroll të Implementimit të Legjislacionit dhe Përfitimeve nga zyrat regjionale të administratës pensionale nga skemat e pagesave të pensioneve.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit Departamenti i Pensioneve	MAP		
5.1.4	Divizioni i Sigurimeve Pensionale dhe Konventave Ndërkombëtare të emërtohet Divizion për Pensionet e Jashtme, ndërsa çështjet e konventave dhe marrëveshjeve bilaterale do të kalojë në përgjegjësi të DIEKP.	Shkurt 2012	Zyra e Sekretarit Departamenti i Pensioneve	MAP		
Masa 5.2	Në periudhë afatmesme për administrimin e të gjitha skemave të financuara nga buxheti i shtetit themelohet Agjencia e Administratës Pensionale, ndërsa funksionet e zhvillimit dhe monitorimit të politikave për të gjitha llojet e pensioneve dhe beneficioneve do të organizohen në kuadër të një departamenti.	MPMS, Departamenti i Pensioneve, TRUSTI			Shtator 2013	

Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
5.2.1 Nga strukturat operative e Departamentit të Pensioneve që merret me implementimin e pagesave të skemave pensionale do të themelohet Agjencia e Administratës Pensionale	Mars 2013	MPMS	MAP, MF, ZKM		
5.2.2 Transferi i menaxhimit të skemës së pensioneve dhe beneficioneve të invalidëve të luftës në Agjencinë e Administratës Pensionale	Shtator 2013	MPMS	MAP, MF, ZKM		
5.2.3 Funkcionet e zhvillimit dhe monitorimit të politikave për të gjitha llojet e pensioneve dhe beneficioneve do të organizohen në kuadër të Departamentit të Pensioneve dhe Beneficioneve.	Dhjetor 2013	MPMS	MAP, MF, ZKM		
Masa 5.3	Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave koordinues për shkëmbimin e të dhënave në mes Departamentit të Pensioneve, si përgjegjës për administrim të skemave pensionale të shtyllës së I-rë të pensioneve dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, që administron kontributet pensionale të shtyllës së II-të të pensioneve.		MPMS, Departamenti i Pensioneve ,TRUSTI		Shtator 2013
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Kostot buxhetore	Burimet e financimit
5.3.1 Nënshkrimi i Marrëveshjes se Mirëkuptimit në mes të Departamentit të Pensioneve dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovë për të kalkuluar periodat e kontributeve brenda dhe jashtë vendit.	Mars 2012	MPMS, DP	MF, ZKM, BQK		
5.3.2 Agjencia e Administratës Pensionale dhe Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovë do të krijojnë mekanizma për shkëmbimin e të dhënave të përfitueseve të pensioneve nga shtylla I-rë dhe kontributeve nga shtylla II-të	Shtator 2013	MPMS, DP	MF, ZKM, BQK		
5.3.3 Organizimi strukturave që menaxhojnë me fushën e pensioneve (Agjencisë së Administratës Pensionale dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës) në një organ të vetëm nën monitorimin e shtetit.	Dhjetor 2013	MPMS, DP	MF, ZKM, BQK		

